



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA VLORË**  
**KËSHILLI I BASHKISË**

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2023

Procesverbal  
Nr 16, datë 30.12.2022

I mbledhjes së këshillit të bashkisë, e cila zhvillohet në sallën e mbledhjeve në Pallatin e Kulturës “Labëria “ ( Ora 10<sup>20</sup>)

Marrin pjesë:

- |                     |                      |
|---------------------|----------------------|
| 1.Sulltana Bilbilaj | 19.Englantina Imeraj |
| 2.Edison Kapaj      | 20.Istref Dobi       |
| 3.Ramona Jaho       | 21.Ina Islamaj       |
| 4.Anisa Shametaj    | 22.Mujo Shakaj       |
| 5.Bujar Osmanaj     | 23.Edlira Kapllanaj  |
| 6.Simo Petromilo    | 24.Gentian Hamzaraj  |
| 7.Klearda Rapushi   | 25.Roneda Muçaj      |
| 8.Adiola Gjoka      | 26.Grigor Dede       |
| 9.Brunilda Cani     | 27.Teki Xhemalaj     |
| 10.Liljana Breshani | 28.Sokol Kushta      |
| 11.Paula Sullaj     | 29.Pëllumb Nezha     |
| 12.Jonela Halili    | 30.Lindrit Beqiraj   |
| 13.Asime Feraj      | 31.Ervis Moçka       |
| 14.Andi Resulaj     | 32.Kreshnik Tepelena |
| 15.Sulejmën Bubeqi  | 33.Jerina Dervishaj  |
| 16.Kristaq Meçi     | 34.Ardian Skëndaj    |
| 17.Fatos Rukaj      | 35.Briseida Çakëri   |
| 18.Brunilda Saliaj  | 36.Kasëm Mahmuti     |

Mungojnë :

- 1.Migena Balla
- 2.Anxhela Aliraj
- 3.Arben Meksi
- 4.Evis Allushi
- 5.Klara Bajaziti
- 6.Besian Gega
- 7.Frosina Qyrdeti
- 8.Rudi Pashaj
- 9.Ervis Caushaj
- 10.Julian Blea
- 11.Elona Toçaj
- 12.Alboren Aliaj
- 13.Rozina Kormuzi



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA V Lorë**  
**KËSHILLI I BASHKISË**

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2023

Procesverbal  
Nr 16/1, datë 30.12.2022

Znj. Jonela Halili – Përshëndetje !

Sikurse jeni njohur me rendin e ditës, sot mbli dhemi për mbledhjen e datës 30.12.2022, me rend dite ( lexon rendin e ditës ).

Keni ndonjë pyetje në lidhje me rendin e ditës ? Votojmë ?

Votohet.

Pro – të gjithë

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota

Miratohet rendi i ditës.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA VLORE**  
**KËSHILLI I BASHKISË**

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2023

Procesverbal  
Nr 16/2, datë 30.12.2022.

Znj.Jonela Halili – Kalojmë në pikën 1 të rendit të ditës, në miratimin e projekt vendimit “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025”.

Fjalën e ka administrata me relacion spjegues.

Z.Daut Zëraj - Në këtë material është reflektuar heqja e subvencionit sipas kërkesës së këshillit bashkiak dhe 2- transfertat u rrit dhe u refelektua në programin buxhetor afatmesëm dhe, gjithë treguesit sipas dispozitave. Është detyrim të paraqiten sipas vitit të kaluar.

Znj.Jonela Halili – Keni pyetje ?

Znj.Brunilda Saliq - Janë plotësuar të gjitha fishat për buxhetin afatmesëm..Nuk rakordojnë shifrat për vitin 2023 – 2025 dhe buxhetin e vitit 2023.(totali i buxhetit ) 2.497.0..dhe 2.500.000..

Z.Daut Zëraj – Nuk është llogaritur blerja e një skrepi dhe për një tokë bijqësore, kjo është diferenca. Kjo shifër do pasqyrohet. Në buxhet është llogaritur.. Do pasqyrohet edhe në buxhetin afatmesëm sepse u depozitua më parë .

Znj.Jonela Halili – Duhet rakorduar dhe për ministrinë . Ka pyetje ?

Kalojmë në votim .

Votohet.

Pro – të gjithë

Kundër – 0

Abstenim – 0

Miratohet.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA VLORE**  
**KËSHILLI I BASHKISË**

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2023

Procesverbal  
Nr 16/3, datë 30.12.2022.

Znj.Jonela Halili – Kalojmë në pikën 2 të rendit të ditës, në miratimin e projekt vendimit “Për miratimin e buxhetit të bashkisë për vitin 2023”.

Fjalën e ka administrata.

Z.Daut Zëraj – Projekt buxheti është përgatitur nga administrata, duke dëgjuar, bërë dëgjesa publike në 5 rajonet, njësitë administrative, grupet e tjera të interesuara, etj. Të gjitha këto janë vlerësuar nga administrata. Janë pasqyruar kësti i kredisë dhe kredia e Landfilldit .

Po ju paraqesim treguesit.

Të ardhurat - 256033 në mijëra ..nga të cilat të ardhurat e veta ...dhe, transferta e pakuf...

Transferta specifike ....

Planifikimi i të ardhurave , në total , janë 7% më shumë. Shpenzimet , janë paga plus sigurime 709.....mijë lekë

Shpenzimet operative 924.759.000. Ka rritje të vogël të treguesve. Administrata, do të paraqesë tjetër buxhet, nëse ka ndonjë sygjerim këshilli.

Gjatë diskutimeve në mbledhjet e komisioneve, ka disa pyetje, dhe dua tu përgjigjem

1.Sektori i pastrimit , në NSHP është krijuar me vendim këshilli bashkie dhe ka shërbime që, nuk i mbulon firma e kontraktuar, pikërisht , është llogaritur fondi përkatës.

2.Kopshti Nr 11 - Duheshin bërë disa riparime nga fondi i bashkisë. Kurse nga fondet e firmës së huaj , nuk mbulohen të gjithë. Nuk është prokuruar.

3.Projektet në buxhetin e vitit 2023, ashtu sikurse në vitin 2022, administrata e bashkisë, mendon që, projektet që janë të planifikuara duhen vazhduar, në këtë vit buxhetor.

Rruga Drithas , është prokuruar, por s’ka filluar, prandaj, nuk e heqim dot. E njëjta gjë dhe për rrugën e Kërkovës, kështu dhe për projektet e tjera.

4.Përfundimi i sallës së këshillit, fillimisht 445 miljon lekë është prokuruar, por për arsye të subjektit fitues, ka nxjerrë pretendime dhe, nuk ka realizuar punimet. Me propozim të supervizorit , administrata e bashkisë vendosi të ndërpresë , të zgjidhë kontratën.

Tek projekti i ri i paraqitur, është bërë një shtesë punimesh , bazamente betoni, podjumi, suvatime të brendshme, elektrike, MNZ. Për këto është shtesa e fondit.

5.Për projektet e huaja, diferenca, vjen për faktin që në vitet e tjera , diferencat kanë qenë më të ulëta.. Si e ardhur, është e njëjta shifër, por si shpenzime nuk janë realizuar. Prandaj është diferenca.

Pak a shumë këto kisha.Nëse ka pyetje ...?

Znj.Jonela Halili – Ka pyetje ?

Z.Ardian Skëndaj - Për kopshtin Nr 11. Keni ardhur , keni kërkuar 2 milion lekë . e keni refuzuar, pastaj 2,8 milion lekë. U refuzua se ka patur anomali. Në buxhet e sillni 4,3 milion lekë. Si rritet kështu? Pse? Është diferencë shumë e madhe.

Znj.Aulona Veizi - Unë kam kërkuar për shkollën “15 Tetori “. Dua një sqarim. Projekti është për eficientë e energjisë elektrike , kjo ka preventivin e saj. Disa zëra mbuloheshin , por projekti nuk mbulonte shumë zëra. Për kapot dhe të gjitha të tjerave, dhe pa tualete, e gjitha do binte ...,ndaj janë këto shtesa.

Z.Ardian Skëndaj - Duam sqarim për shumën 1,5 milion të rritur nga muaji tetor. S’ka projekt, as preventiv, asgjë. S’kemi asnjë projekt serioz. Zyra e Urbanistikës, është joeficiente. Zero aplikime për shkollat dhe, ju thoni, Ministria e Arsimit. Prandaj , vijnë dhe për rrugët përsëri nga vitet e tjera. Salla e këshillit do 4,7 milion , jo 67 .Pa sqarime. Ka mangësi pa fund. Ne kemi marrë disa vendime që do i lexojmë. Të njëjtat projekte , 3 vjet rresht.

Këtë dua unë, 4,3 milion lekë, pa projekt. Si ka mundësi ky ndryshim. I sqaroni mirë këto gjëra. Faleminderit.

Znj.Liljana Breshani - Ne buxhetin e vitit 2022, ishte një shifër për kafshët. Çfarë është bërë në këtë buxhet . Është vënë në punë, apo e mbartur ?

Z.Daut Zëraj – Po. Ka qenë një fond. Nuk është konsumuar, pasi nuk është bërë procedurë. E kemi përsëri për vitin 2023. Të shohim. Dua të sqaroj për kopshtin nr 11.

Znj.Jonela Halili – Ka pyetje të tjera ?

Z.Teki Xhemalaj – Zoti Ardian , ka shumë të drejtë. Për pjesën e ndërtimit, nuk është e konsiderueshme. Por, nëse nuk sqaroni me letra...nuk kemi probleme.

Z.Daut Zëraj – Kur është bërë projekti i huaj, ne nuk ishim duke bërë buxhetin dhe, bëmë një projekt minimal. Ndërsa tani që po bëjmë buxhetin, e kemi tamam projektin.

Znj.Aulona Veizi - Duam që problematika e kopshtit , të mbyllet.

Z.Ardian Skëndaj – Çfarë projekti keni aplikuar? Asnjë.

Znj.Jonela Halili – Mos të zgjatemi kot këtu.

Znj.Edlira kapllani - Si anëtare e komisionit të arsimit, edhe këtë buxhet , nuk është vënë në dispozicion për arsimin 9-vjeçar, fond. Me çerdhet. Ka shumë probleme me fëmijët që s’kanë ku të shkojnë . S’ka vende në çerdhe.

Duhet një projekt për palestrën e shkollës “4 Heronjtë “

Tjetër. Si përfaqësuese e komunitetit me më shumë nevojë , duhet një fond i veçantë

për restaurimin e shtëpive për komunitetin rom dhe egjiptian.

Z.Daut Zëraj - Për arsimin 9-vjeçar, është i njëjti fond dhe për këtë vit. Mbase realizohet.

Për çerdhen në këtë buxhet nuk mundet.

Znj.Sulltana Bilbilaj – Duke krahasuar buxhetin e vitit 2022 me buxhetin e vitit 2023, shoh të njëjtat investime . Pse, zero përqind investime në shkolla ? Pse ?

Tjetra. Kopshti nr 8 në Skelë, për një kredi 1 milion lekë/muaj meqenëse dhe kushtet janë skandal. Të shkojë komisioni , të verifikojë. Të kalohet në një godinë tjetër me kushte.

Z.Daut Zëraj - Investimet në shkolla, ishin planifikuar bashkë me ministrinë e linjës dhe, nuk u arrit gjë.

Z.Ardian Skëndaj – A i keni paraqitur projekte ministrisë? Po apo jo.

Z.Daut Zëraj - Ndaj ne kemi kërkuar me fondet tona ..

Z.Ardian Skëndaj – Sa projekte keni aplikuar në Minsitrinë e Arsimit . Mos i'a hidhni fajin qeverisë.

Z.Daut Zëraj – Për kopshtin nr 8, mbetet për ta vlerësuar.

Z.Kasëm Mahmuti – Do e marr fjalën pastaj.

Z.Sokol Kushta - Sot ne vijmë për buxhetin, me rëndësi shumë të madhe, por kryetari, s'është, nuk e di si ndiheni. Falënderoj z.Daut , por s'ka çtë bëjë dhe ai. Dje në mbledhjen e komisionit të arsimit dhe sporteve , ishim në një dhomë 2x2, si i burgosur, 1 orë e 30 minuta..Komisioni i sportit, sporti është në tërësi.., fillon nga baza. Bashkia s'duhet të japë fonde bakshish, jo.

Bashkia duhet të bëjë projekte për zhvillimin e sportit, palestra etj, dhe për sportistët duhet të ketë vlerësime .

Unë nuk shikoj asnjë investim për sportin. Jepuni një stimulim sportistëve. Lagjet janë copë copë. Zbukurimet, janë vetëm në vende preferenciale. Vlora është gjithandej. Taksat janë tonat.

Kur i zoti i shtëpsë ikën me pushime, ne ndihemi të nënvlerësuar.

Znj.Brunilda Saliaj – Tek investimet, nuk është planifikuar asnjë parkim për autobuzat e linjave , pasi rrugët bllokohen nga autobuzat.( 3 muaj e keni investuar )

2.Tek shkolla e Marinës , Rehabilitimi i shtyllave elektrike, rishikimi i projektit- parkim publik, në Lungomare. Në 1 km rrugë, kaq shumë investime ? Thjesht , të përmirësohet parkimi që është .

Z.Edison Kapaj – Falënderoj për rrugën në fshatin Kërkovë. Por, për Bestrovën, jo që nuk u krye investimi, por as nuk është as në buxhet. Njësia Qendër ka shumë problematika.

Z.Ervis Moçka - Filozofia e këtij buxheti, kush është ? Prioritetet e këtij buxheti ? Kujt i është dhënë prioritet ? Zhvillimi ekonomik, investimet në rrugë, turizmi apo çfarë ? Thjesht me disa kërkesa, kënaq dikë dhe pakënaq shumë ?

Dhe e dyta, nga intervistat dhe sondazhet , kush është para ?

Znj.Aulona Veizi - Duke bërë dëgjesa me publikun, merret feedback dhe hidhen në letër . Të gjitha rezultojnë në zhvillimin ekonomik, të gjitha në funksion të qytetarëve dhe të turizmit.

Baza është dëgjesa dhe, e gjitha është zhvillimi ekonomik dhe turizmit.

Znj.Asime Feraj - Doja të përforcoja, atë çka tha zoti Ervis. E para dhe motivi në të cilin duhet të udhëhiqet puna e administratës së bashkisë , është rritja e cilësisë së jetesës së qytetarëve.

Z.Ruga Bishti i Kalldrëmit - Kaninë , i ka kaluar pushtetit vendor. Në jesën lidhëse të rrugës Kaninë , gjendja është shumë e vështirë. Është 30m rrugë e pakalueshme , pika e takimit Kaninë – Bypas.

Z.Daut Zëraj – Mbetet për tu vlerësuar rruga e Kaninës. Ndërsa për Bestrovën , këto projekte do i shohim si do mbyllet viti 2022 dhe, do i pasqyrojmë. Ndërsa stacioneve nuk i përgjigjem, lidhur me çështje personale nuk flas.

Znj.Brunilda Saliaj – Këtu s’ka asgjë personale.. Në behar tek parkimi nuk gjen vend.

Z.Daut Zëraj – Projektin e keni dhënë dje.

Znj.Brunilda Saliaj - Dje në komision s’është diskutuar.

Z.Daut Zëraj - Është kaluar në viitn e kaluar.

Z.Ardian Skëndaj - Me ligj, s’duhet të jeni ju aty, e keni nga halli. Sot Dauti është impulsiv.

Zyra e projekteve nuk funksionon.

Z.Simo Petromilo – Mbështes zonjën Feraj, për rrezikun e rrugës së Kaninës. Por, tjetër problem, është rruga që e keni përmendur 3 vjet rresht, rruga “Kristo Negovani “ – “ Halim Xhelo “ – “ Holliday “, kësaj radhe nuk është përmendur fare. Kjo rrugë është geto. Në gjithë këto vite nuk është vënë dorë. Në Drejtorinë e Urbanistikës asnjë nuk mban përgjegjësi.

Së dyti, Dua një sqarim sa është buxheti për bujqësinë për vitin 2023, duke qenë se, Bashkia Vlorë është bashkuar me 4 njësitë administrative.

Z.Zambak Selmani - Për rrugën e Kaninës, kemi folur me ARRSH-në , të na lejojë akses në asfaltim. Nëse na jep lejen , atëherë do ta shtrojmë .

Rruga Halim Xhelo – Holliday, është shtruar me asfalt nga FSHZH-ja. Ndriçimin po e bën bashkia dhe, trotuarët do ti shtrojë bashkia në vitin 2023.

Znj.Aulona Veizi - Buxheti është ndarë sipas zërave . Për bujqësinë , dhe unë punoj dhe kam punuar për bujqësinë dhe për sensibilizimin të marrjes së fondeve për fermerët dhe bashkëpunojmë me AZHBR-në. Ne po punojmë për këtë gjë dhe për fermerët të marrin fonde nga Bashkimi European.

Z.Fatos Rukaj – Për investimet , unë s’do të kërkoj për lagjen time, por do përmend një fshat , Grabianin, që i ka ujrat e zeza në sipërfaqe. Nëse do shpërthejë pandemia , është e kotë. Është emergjente për kanalizimet atje. Pse është hequr projekti i Bestrovës ?

Z.Daut Zëraj – E sqarova dhe më parë, në buxhetin e rishikuar do pasqyrohen të gjitha.

Z.Kasëm Mahmuti - Ky është buxheti i fundit për ne si këshilltarë. Paga plus sigurime , ka rritje 15%, investimet 2.7 % , kjo është filozofia. Rritje dyshifrore paga , shpenzimet operative , kurse investimet 2.7%. Pa futur efektin e rritjes së çmimeve. 1260 të punësuar. Punëdhënësi më i madh në Vlorë .

Diku ka mospërputhje të të ardhurave . Në mbledhjen e kaluar , miratuam shtesën në pyjore dhe



MZSH, fondi i pagave. Nuk është përfshirë shtesa, ka pasaktësi . Çështja e e taksës së pastrimit, gjelbërimit, banesës nga ana e familjarëve që mblidhen nga Ujësjellësi . Në relacion thuhet se, është e pamundur të mblidhet . Administrata duhet të gjejë zgjidhje. Nuk është e drejtë që këto taksa ti paguajnë ata që janë jashtë dhe ata këtu, nuk paguajnë.

Taksa e fjetjes në hotel, u gjet një alternativë. Po ashtu për taksën bujqësore . Në fund fare, kjo sasi lekësh , ku do reflektohet .

Në lidhje me shpenzimet.

E para, në shërbimin e pastrimit , kemi 3 kontrata. E para, Vlora përfundon në muajin korrik, njësitë në muajin korrik dhe Orikumi në muajin mars 2023.

Sa janë sipërfaqet që do pastrohen? Sa janë mbetjet ?

Nuk është e qartë asgjë për pastrimin.

Dhe ,e fundit , doja shumë përgjigje për këto çështje që ngrita.

Dje në diskutim, ishte pagesa për energjinë i miliard lekë/vjetra . Për ndriçimin, kalimi në led ul 30% shpenzimin. Ndriçimi rrugor është 174.000 km, rregullojeni këtë. ( lapsus)

Z.Daut Zëraj - janë për tu vlerësuar këto që tha zoti Kasëm dhe shërbejnë për të përmirësuar punën. Shifrat që tha, janë të sakta. Tek shpenzimet operative , një pjesë e konsiderueshme, hyjnë ndriçimi, pastrimi, etj .Megjithatë, ka për të përmirësuar në këtë drejtim.

Znj.Jonela Halili - Në faqen 89, sektori i pastrimit, tek zëri karburant, elektrik.... janë 25 milion, këtu është ndryshuar 50.

Z.Daut Zëraj – Nuk ndikon, është lapsus.

Z.Ardian Skëndaj – Njoftime në televizione 4 milion lekë.Ok, po dhe këshilli ka aktivitetet e tij. Pse s’ka këshilli fond për njoftime.

Z.Daut Zëraj – S’keni kufizime ju për njoftime.

Z.Ardian Skëndaj – Në buxhetin shtesë, të ketë dhe për këshillin fond për njoftime në televizion.

2.Fshatrat Bestrovë e Panaja , pa ujë. Narta problematike. Si nuk ka investime për këto ?

Analizën e investimeve të planifikuara , nuk na e ke sjellë. Analizën 8 – mujore, nuk e keni sjellë. Tani vini, kërkoni lekë.

Z.Grigor Dede - Dje në mbledhjen e komisionit, kishte goxha debate. U kërkua dje në komision 500.000 për sportin dhe për klubin e Orikut, mbështetje . Të shikohet mundësia.

Për transparencë , duhet raportim mujor, për çdo ecuri mbi buxhetin.

Z.Ardian Skëndaj - Para se të kalojmë në miratim, duhet të japim disa mendime:

-Ka rritje prej 32%

-Të ardhurat e veta 1.72%

-Grantet 19%

-Grantet specifike 4.2%

Këta tregues janë premtues. Të ardhurat e bashkisë, janë në nivel të kënaqshëm. Drejtoria e planifikimit urban të sqarojë taksën e ndikimit në infrastrukturë. Administrata tatimore, është brenda parametrave ligjore, por jo maksimale.

Fondet e granteve të pakushtëzuar dhe ai specifik (44,06% në total ) tregojnë vëmendjen e qeverisë. Duhet realizuar 100%.

Kapitulli i shpenzimeve. Duhet të jemi të kujdesshëm në vendimmarrje.

Shifrat janë :

-Pagat plus sigurimet shoqërore 15.3%

-Shpenzimet operative 9.8%

Investimet, diferencë e vogël. Shpenzimet e tjera, kanë ulje.

I propozoj këshillit, të bëjë ndryshimet:

1.Sektori i pastrimit, të rishikohet. Duhet strategjia 3 vjeçare . Grupi i menaxhimit strategjik, duhet të miratojë këtë strategji.

2.Në pikën 14 të shtohet: Të sjellë studimin afatmesëm 3 vjeçar.

-Salla e mbledhjeve të këshillit të bashkisë. Diferenca 22.5 miljon, të shtohet në investimet e rajoneve. Për kë janë rritur çmimet, për sipërmarrësit apo Bashkinë ?

Ndërtimi i sallës plus sistem ngrohje, të bëhet 44.5 , sa çka qenë , sa të zgjidhet konflikti. Kur të sillni argumentat , kalojmë 22.5, të tjerat.

3.Ndërhyrje në fasadat e pallateve

Skrofotinë, Radhimë, Demokracia..

I kemi miratuar me VKB NR 84, lënë në fuqi me VKB Nr 4 datë 31.01.2021. pse nuk janë realizuar këto investime ? Administrata, të hartojë projekt preventiv deri në muajin shkurt.

4.Nga fondet e trashëguara , 2021.

Miratimi i fondeve – Oriku, Gjergj Kastrioti. Aksi Shaban Demiraj , aksi Dhimitër Konomi, Blloku “Çamëria “....

Shpronësime në rrugën “Pelivan Leskaj”

Shkolla e Marinës –Gjykatë , rehabilitim, stacion elektrik, parkim.

Administrata nuk i ka përdorur në vitin 2022 këto fonde, të garantuara. Nga këto shkelje , duam për objektet me V..Nr 24 datë 28.03.2022 lënë në fuqi, të paraqiten në buxhetin shtesë , ku këto fonde janë të planifikuara, sillni është .....

Diferencat të përdoren për rrugë, investimet rrugore.

5.Projekt buxheti nuk morri kohën e mjaftueshme , sipas ligjit. Por, propozojmë saktësimin e këtyre pikave deri në muajin shkurt

-Projekt preventivat

-Investimet e projekteve, ti kalojnë rajoneve

Znj.Jonela Halili - Relacioni është paraqitur pranë sekretariatit. Duhet ti citojnë.

Z.Ardian Skëndaj - Në buxhetin shtesë të rishikohen sportet dhe kultura. Nëse nuk vijnë të rishikuara, nuk e di ....

Z.Daut Zëraj - Ky projekt buxhet , o votohet , ose s’votohet. Duhet të kalojë siç është.

Znj.Jonela Halili – Ndryshimet e kërkuara me bazë ligjore, sipas ligjit, Propozoj:

1.Pika 5 e projekt vendimit, sipas pikës 2/6...ndërtimi i sallës së këshillit të Bashkisë Vlorë, të ndryshojë shuma.

2.Objekti i fasadave të pallateve, asfaltimet etj, të hartohen projekt preventivat deri në muajin shkurt.

3.Projektet me fondet e trashëguara me VKB Nr 4 datë 31.01.2022, të paraqiten..., shuma të kalojë për rehabilitim të rrugëve..

Rikonstruksioni “Gjergj Kastrioti “ – Orikum, “Dhimitër Konomi “, Blloku “Çamëria “, shpronësimet , vijnë ...

Faza ë fundit , shkolla e Marinës - Regina City- Stacioni elektrik, parkimi...

4.Brenda muajit shkurt të paraqitet projekt preventivi për sistemimet.....Shuma të përdoret për këto sistemime. Fondi për projekte kulturore të përdoret, kur administrata të sjellë projekt preventivat.

Të rishikohen fondet për disiplinat sportive .

Në pikën 13 , vendimet e gjykatës të merren parasysh siç i ka lënë gjykata Studim afatmesëm 3 vjeçar (pastrimi ).

Z.Teki Xhemalaj – Janë shtuar të gjitha ?

Z.Kasëm Mahmuti – Viti i ardhshëm , është vit elektorale, të gjitha janë në kurriz të qytetarëve. Themi investimet mos ti prekim.

Z.Ervis Moçka - Për preventivat ,ok, le ti sjellin.

Fondi 67, është tenderuar 44, s’ka problem. Shtesat dhe ndryshimet, janë detyrime ligjore.

Z.Daut Zëraj – Bëhet i paligjshëm buxheti me këto ndryshime. Buxheti nuk funksionon kështu. Buxheti është një, shpenzimi i parë, është pagesa e parë .

Ndryshimet që keni propozuar janë në kundërshtim , kështu buxheti nuk shkon.

Projektet që u propozuan, mund të shtohen . Këtë , ose e miraton ose e rrëzon.

Indirekt na duket sikur rrëzohet buxheti. Sepse kështu nuk është i ligjshëm.

Znj.Jonela Halili - Kalojmë në votim , bashkë me propozimet e grupit të socialistëve

Pro – 33 vota

Kundër – 2 vota.

Abstenim – 1 votë .

Z.Daut Zëraj - Jo, ky buxhet quhet i rrëzuar, nuk është i ligjshëm kështu.



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA VORË**  
**KËSHILLI I BASHKISË**

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2023

Procesverbal  
Nr 16/4, datë 30.12.2022.

Znj. Jonela Halili – Kalojmë në pikën 3 të rendit të ditës, në miratimin e projekt vendimit  
“ Për miratimin e kalendarit të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026”.

Ka ndonjë pyetje? Ka nevojë për relacion ? – Jo

Kalojmë në votim. Votohet.

Pro – 36 vota.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA V Lorë**  
**KËSHILLI I BASHKISË**

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2023

Procesverbal  
Nr 16/5, datë 30.12.2022.

Znj.Jonela Halili – Kalojmë në pikën 4 të rendit të ditës, në miratimin e projekt vendimit  
“Për dhënie titulli “Qytetar Nderi i Vlorës” z. Bujar Asqeriu”.

Kalojmë në votim. Votohet.

Pro – 36 vota.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Miratohet.



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA V Lorë**  
**KËSHILLI I BASHKISË**

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2023

Procesverbal  
Nr 16/6, datë 30.12.2022.

Znj.Jonela Halili – Kalojmë në pikën 5 të rendit të ditës, në miratimin e projekt vendimit “Për dhënie titulli “Qytetar Nderi i Vlorës” z. Haxhi Baba Sadik Ibrokodheli “.

Votohet.

Pro – 36 vota.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Miratohet .

Mbajti Procesverbalin

Aida Hitaj

V.O: Bashkëlidhur këtij procesverbal , gjendet relacioni për propozimet e grupit socialist.